



A.nr.1909/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1909/2025 të datës 17.11.2025 të parashtruar nga ankuesi A.G, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1909/2025, e datës 16.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.G.

**II. Ndryshohen** Lista e verifikimit paraprak lidhur me konkursin me numër të referencës RN00018442; Njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, lidhur me prapen e kalueshmërisë së kandidatëve nga testi me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe Njoftimi me Nr. prot. 3972 i datës 31.10.2025, për kandidatët fitues, në atë mënyrë që: kandidatët M.S-S, B.K, B.M dhe A.Z-S, largohen nga Lista e verifikimit paraprak, Njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, Renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe Njoftimi me Nr. protokoll 3972 i datës 31.10.2025, për kandidatët fitues, ndërsa, kandidatët E.K dhe A.D, largohen nga Lista e verifikimit paraprak, njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, dhe Renditja përfundimtare e kandidatëve.

**III. Obligohet** Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, si dhe të bëjë përzgjedhjen e kandidatit të dymbëdhjetë (12) fitues për pozitën e punës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm duke u bazuar në Renditjen përfundimtare të kandidatëve, të ndryshuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

### **A r s y e t i m**

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.G (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 17.11.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7382/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër konkursit me Nr. reference RN00018442, të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 19.08.2025, për pesëmbëdhjetë (15) pozitat e punës: Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.11.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.12.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7382/2025 të datës 17.11.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Dokument identifikimi i ankuesit; Njoftimet nga SIMBNJ me 3 E-mailat e datës 31.10.2025 dhe 2 E-mailat e datës 23.10.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 04.12.2025; Konkursin me Nr. reference RN00018442, të datës 19.08.2025; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Vendimin me Nr.Ref 432/2025 të datës 08.10.2025; Akt emërimin me Nr.280/2025 të datës 01.04.2025; Akt emërimin me Nr.918/2024 të datës 01.08.2024; Akt emërimin me Nr.139/2024 të datës 03.09.2024; Akt emërimin me Nr.120/2024 të datës 10.10.2024; Akt emërimin me Nr.900/2024 të datës 01.07.2024; Njoftimi me Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, lidhur me pragun e kalueshmërisë së kandidatëve nga testi me shkrim; Rënditja përfundimtare e kandidatëve; si dhe Njoftimi me Nr. protokolli 3972 i datës 31.10.2025, për kandidatët fitues; Vendimin me numër protokolli 1083 të datës 10.07.2023; Formularin e përshtimit të punës të pozitës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm; Testet me shkrim të kandidatëve të datës 16.10.2025; Formularët e datës 29.10.2025, të vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatët; Aplikacionin e ankuesit, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates V.M, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit Xh.B, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit E.K, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit A.Z, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates M.S-S, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit B.K, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit B.B, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit N.I, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit M.R, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit A.S, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates D.B, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates B.M, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates A.Z-S, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates B.V, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit D.P, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidates E.K, me dokumentet e bashkëngjitura; Aplikacionin e kandidatit A.P, me dokumentet e bashkëngjitura.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pjesërisht e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 19.08.2025, ka shpallur Konkursin me Nr. reference RN00018442, Grupi i Shërbimit të Jashtëm, përkatësisht për pesëmbëdhjetë (15) pozitat e punës: Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, Klasa Profesional 2, me afat aplikimi nga data 20.08.2025 deri më 18.09.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë dyqind e katër dhjet e një (241) kandidatë, ku prej tyre katër dhjet e katër (44) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin i cili ka marrë pjesë në vlerësimin e testit me shkrim, ku si rrjedhojë ka arritur gjithsejtë 43.2 pikë, të pamjaftueshme për të vazhduar tutje me vlerësimin e testit me shkrim.

Ndërsa, sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve, rezulton se procedura përkatëse e rekrutimit ka përfunduar me gjithsejtë tetëmbëdhjetë (18) kandidatë fitues, të cilët kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale të vlerësimit të përgjithshëm, dhe atë me renditje të tyre si në vijim:

- 1) kandidatja V.M, me gjithsejtë 97.2 pikë të arritura (67.6 nga testi me shkrim, 29.6 nga intervista),
- 2) kandidati Xh.B, me gjithsejtë 95.4 pikë të arritura (67.4 nga testi me shkrim, 28 nga intervista),
- 3) kandidati E.K, me gjithsejtë 94 pikë të arritura (66.6 nga testi me shkrim, 27.4 nga intervista),
- 4) kandidati A.Z, me gjithsejtë 93.4 pikë të arritura (64.8 nga testi me shkrim, 28.6 nga intervista),
- 5) kandidatja M.S-S, me gjithsejtë 90.2 pikë të arritura (63.6 nga testi me shkrim, 26.6 nga intervista),
- 6) kandidati B.K, me gjithsejtë 87.4 pikë të arritura (59.4 nga testi me shkrim, 28 nga intervista),
- 7) kandidati B.B, me gjithsejtë 87.2 pikë të arritura (61 nga testi me shkrim, 26.2 nga intervista),
- 8) kandidati N.I, me gjithsejtë 86.8 pikë të arritura (60.4 nga testi me shkrim, 26.4 nga intervista),
- 9) kandidati M.R, me gjithsejtë 85 pikë të arritura (56.8 nga testi me shkrim, 28.2 nga intervista),
- 10) kandidati A.S, me gjithsejtë 84.8 pikë të arritura (58 nga testi me shkrim, 26.8 nga intervista),
- 11) kandidatja D.B, me gjithsejtë 84.2 pikë të arritura (58.6 nga testi me shkrim, 25.6 nga intervista),
- 12) kandidatja B.M, me gjithsejtë 84 pikë të arritura (56.2 nga testi me shkrim, 27.8 nga intervista),
- 13) kandidatja A.Z-S, me gjithsejtë 84 pikë të arritura (57.8 nga testi me shkrim, 26.2 nga intervista),
- 14) kandidatja B.V, me gjithsejtë 83 pikë të arritura (55 nga testi me shkrim, 28 nga intervista),
- 15) kandidati D.P, me gjithsejtë 78.4 pikë të arritura (51.2 nga testi me shkrim, 27.2 nga intervista),
- 16) kandidatja E.K, me gjithsejtë 74.2 pikë të arritura (61.2 nga testi me shkrim, 13 nga intervista),
- 17) kandidati A.P, me gjithsejtë 73.6 pikë të arritura (60.2 nga testi me shkrim, 13.4 nga intervista), si dhe,
- 18) kandidatja A.D, me gjithsejtë 71 pikë të arritura (57.6 nga testi me shkrim, 13.4 nga intervista).

Si rrjedhojë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 31.10.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3972, sipas të cilit rezulton se pesëmbëdhjetë (15) kandidatët me më së shumti pikë të arritura: V.M, Xh.B, E.K, A.Z, M.S-S, B.K, B.B, N.I, M.R, A.S, D.B, B.M, A.Z-S, B.V dhe D.P, janë shpallur kandidatët fitues të rekomanduar nga Komisioni i Pranimit, për plotësimin pesëmbëdhjetë (15) pozitave të punës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm.

Ankuesi, ankesën e ka parashtruar në Këshill, kundër procedurës të rekrutimit, me pretendime për shkak të shkeljes së dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, andaj, kërkon vendim për pranueshmërinë e ankesës dhe anulimin e konkursit për pozitën Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, i' u referua nenit 27, paragrafit 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili thekson se: *4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidatje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil.*, ndërlidhur me nenin 39 paragrafin 11 të këtij ligji, nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, si dhe nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin përcaktohet se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.*, dhe si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, fillimisht konstaton së Këshilli ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ngase ankuesi ka legjitimitetin e palës në procedurë dhe se ankesa konsiderohet e parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 127, paragrafi 1 të LPPA-së.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka vlerësuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurës e kontestuar, e në këtë kontekst ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00018442, Grupi i Shërbimit të Jashtëm, për pesëmbëdhjetë (15) pozitat Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, Klasa Profesional 2, ku si kërkesa të përgjithshme formale dhe kritere specifike shtesë, për pozitën përkatëse janë përcaktuar:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat si vijon: Shkenca Politike, Juridik, Marrëdhënie ndërkombëtare, politika të sigurisë, studime evropiane, Ekonomi, Juridik, Diplomaci (ekonomike, publike dhe kulturore) Administratë Publike.*

- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës,*

- *Kriteret specifike shtesë: Njohja e gjuhës angleze, gjermane, frënge, italiane, greke, spanjolle në nivelin C1 apo C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.*

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të theksuara si më lartë, janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht me Shtojcën Nr.1/6 Përshkrimi i

përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2, Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, Grupin Nr.14 të Shërbimit të Jashtëm, si dhe me katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, të miratuar sipas Vendimit me Nr.08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e në të cilin katalog janë paraparë emërtimet e pozitive/vendit të punës, kodet, klasat, emrin e grupit si dhe fushat e kërkuara të arsimit, ku pozita Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm parashihet me kod SHC-0947, klasë profesional 2 dhe Grupin e shërbimit të jashtëm. Ndërsa, kriteret specifike shtesë rezultojnë se janë vendosur në pajtim me Formularin e përshkrimit të punës të pozitës përkatëse, të miratuar sipas Vendimit me PDP. Nr.02/2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Më tej, nga analizimi dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezultojnë se edhe përbërja e Komisionit të Pranimit, të themeluar sipas Vendimit me Nr. Ref 432/2025 të datës 08.10.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përgjegjës për vlerësimin profesional të kandidatëve për plotësimin e pozitive Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, është në pajtim me kërkesat ligjore të caktuara me nenin 40 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku theksohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për praninë në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*; si dhe nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.10/2024 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, për arsye se kryesuesi i komisionit z. M.T, sipas Akt emërimit me Nr.120/2024 të datës 10.10.2024, mbanë pozitën e punës të kategorisë së mesme drejtuese: Drejtorit të Departamentit për Evropë BE dhe Rajon; anëtarja znj. H.K, sipas Akt emërimit me Nr.280/2025 të datës 01.04.2025, mbanë pozitën e punës së kategorisë profesionale të fushës përkatëse: Zyrtare për Shërbime të Jashtme; anëtarja z. L.V, sipas Akt emërimit me Nr.918/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën e kategorisë së ulët drejtuese: Udhëheqës i Divizionit për Planifikim dhe Koordinim të Politikave; anëtarja znj. K.A-O, sipas Akt emërimit me Nr.521/2025 të datës 28.05.2025, mbanë pozitën e kategorisë së ulët drejtuese: Udhëheqëse e Divizionit për Azinë Juglindore dhe Oqeaninë, si dhe anëtarja znj. F.F, e cila sipas Akt emërimit me Nr.900/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Njeriut, pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e përfaqësueses nga NjMBNj.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, i' u referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë: Nenit 9, paragrafit, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.* Nenit 39, ku përcaktohet se: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo*

grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimit i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.; si dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2024 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, përkatësisht Nenit 8, i cili përcakton se: Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj. Nenit 9, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit

*të Pranimiit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni behët publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.*

Bazuar në dispozitat e lartë theksuara dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit, rezulton se vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit me shkrim kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa, nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidatë tjerë i janë nënshtruar testit me shkrim, si rrjedhojë ankuesi ka arritur t'i mbledh gjithsejtë 43.2 pikë, respektivisht 36 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë prej 50 pikëve sa është maksimumi dhe 7.2 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur t'i marr pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.*; ndërsa, testin me shkrim rezulton se e kanë kaluar gjithsejtë njëzet e shtatë (27) kandidatë, të cilët kanë arritur pragun e kalueshmërisë prej pesëdhjetë (50) pikëve, prej shtatëdhjetë (70) pikëve maksimale, duke vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit, pretendimet ankimore të ankuesit nuk i vlerëson si të bazuara, për arsye se pyetjet e testit me shkrim rezultojnë se janë parashtruar përkitazi me njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën dhe grupin e pozitës përkatëse, kurse, i njëjti rezulton se ka arritur të ofroj të gjitha përgjigjet e tij kundrejt pyetjeve të parashtruara nga faza e testit me shkrim të mbajtur me datë 16.10.2025, dhe se duke marrë për bazë se njoftimi për rezultatet e arritura nga kjo fazë vlerësimi, ankuesit sikurse edhe kandidatëve tjerë, i dërgohet në mënyrë automatike nga sistemi SIMBNJ, andaj, Kolegji i Këshillit, mbi këtë bazë dhe provave të bashkëngjitura nga palët në procedurë, nuk ka arritur të vlerësoj se ankuesit i është cenuar ndonjë e drejtë nga kjo procedurë rekrutimi, apo se i njëjti nuk është trajtuar njëjtë sikurse kandidatët tjerë, për faktin tani më të përsëritur se pyetjet dhe kohëzgjatja nga testi me shkrim, kanë qenë të njëjta sikurse për ankuesin dhe kandidatët tjerë pjesëmarrës në këtë fazë rekrutimi, ndërsa, vlen të theksohet se përgjigjet e pyetjeve me zgjedhje të shumëfishte vlerësohen automatikisht nga sistemi kompjuterik i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, përveç esesë e cila vlerësohet nga Komisioni përkatës i pranimiit.

Tutje, në kontekst të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimi, e bazuar në nenin 9 paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (*të pasqyruar si më lartë*), si dhe nenin 6 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.10/2024 për Procedurën e Pranimiit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara*

në aplikacion...e gjithashtu referuar pikës 5 të shpalljes së konkursit, rezulton se të gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar me dokumentet që duhej dorëzuar me rastin e aplikimit në procedurën përkatëse, duke përfshirë këtu:

*-Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;*

*-Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;*

*-Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.*

*-Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit;*

*-Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;*

*-Dokumente që dëshmojnë njohjen e gjuhës angleze, gjermane, frënge, italiane, greke, spanjolle në nivelin C1 apo C2. Njohja e gjuhës dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.; dhe mbi këtë bazë ligjore, e bazuar në kërkesat e përgjithshme formale si dhe kriteret specifike shtesë, Kolegji i Këshillit, ka analizuar dhe shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve, të cilët në kuptim të nenit 39 paragrafit 11 të Ligjit Nr.08L-197 për Zyrtarët Publik dhe paragrafit 2 të nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, janë shpallur kandidatë fitues, dhe atë duke filluar sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të përgjithshme të vlerësimit të kandidatëve, nga rezulton se:*

- Kandidatja V.M, me gjithsejtë 97.2, pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor dhe plotësimin të kriterit specifik shtesë, ka bashkangjitur Diplomën e lëshuar më datë 10.07.2014 , nga “The American College of Thessaloniki”, dhe duke qenë se kjo diplomë është fituar jashtë Republikës së Kosovës, e njëjta rezulton se është njohur me Vendimin Ref.Nr.216-873 të datës 11.11.2024, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Këshilli Shtetëror për Njohje, përmes të cilit dëshmohet se e njëjta ka fituar gradën Bachelor i Arteve në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës profesionale, e njëjta ka bashkangjitur Kontratën e punës me Nr.01/2025 të lëshuar me datë 15.01.2016 nga “Instituti EdGuard”, përmes së cilës theksohet se e njëjta punësohet tek ky punëdhënësi për një *periudhë një (1) vjeçare* me mundësi të vazhdimit për çdo vit, dhe atë në pozitën e Asistentes për hulumtime dhe mësimdhënie; Vërtetimin e lëshuar me datë 31.03.2017. nga Instituti “EdGuard”, në të cilën theksohet se kandidatja në fjalë është e angazhuar pranë këtij punëdhënësi si Sekretare dhe Hulumtuese e Lartë me orar të plotë, nga data 23.11.2015, si dhe Kontratën e punës të datës 15.02.2018, të lëshuar nga “PEN”, përmes së cilës dëshmohet se e njëjta nga data 15.02.2018 deri më 31.12.2018, ka qenë e angazhuar si Asistente e Projektit në kuadër të organizatës Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë dhe projektit Social Act. Andaj, duke qenë kandidatja në fjalë posedon përvojën e punës në sektorin privat apo jashtë institucioneve

publike, e njëjta ka bashkangjitur Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional dhe Vërtetimin Tatimor të datës 22.08.2025, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me listat e pagave përkatëse, përmes së cilave konstatohet se e njëjta posedon *nëntëmbëdhjetë (19) muaj* përvojë pune profesionale pas diplomimit të studimeve themelore, dhe se mbi bazë të këtyre provave materiale rrjedhë se kandidatja në fjalë i plotëson kërkesat e përgjithshme formale dhe specifike të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

- Kandidati Xh.B, me gjithsejtë 95.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.8073, të lëshuar me datë 13.02.2023 nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti Filozofik, me anë të së cilës dëshmohet se i njëjti më datë 14.12.2022, ka mbaruar studimet në Departamentin e Shkencave Politike-Programi Shkenca Politik, duke fituar kështu titullin Bachelor i Shkencave Politike. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit specifik shtesë, ka bashkangjitur Certifikatën me numër protokollit 86/2024 të datës 03.10.2024, të lëshuar nga “English Language School”, me anë të së cilës dëshmohet se i njëjti është angazhuar dhe ka kompletuar përfundimin e gjuhës angleze në nivelin C1, si dhe sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës i njëjti ka bashkangjitur Kontratën për punë praktike me numër protokollit 6022 të datës 12.11.2024, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti nga data 15.10.2024 deri më 15.04.2025 (6 muaj), ka qenë i angazhuar në pozitën e Praktikantit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe Kontratën për punë praktike me numër protokollit 2059 të datës 03.06.2025, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti nga data 15.04.2025 deri më 15.10.2025 (6 muaj), ka qenë i angazhuar në pozitën e Praktikantit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. *(Kandidati posedon edhe përvojë tjetër, por Kolegji për shkak të numrit të madh të aplikacioneve ka administruar vetëm përvojën minimale me të cilën është plotësuar kriteri formal sipas konkursit të lartshënuar)*. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

- Kandidati E.K, me gjithsejtë 94 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.6349, të lëshuar me datë 11.12.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore më datë 04.12.2018, në Fakultetin Filozofik- Departamenti i Shkencave Politike, duke marrë titullin Bachelor i Shkencave Politike, dhe sa i përket plotësimit të kriterit specifik shtesë ka bashkëngjitur Certifikatën me numër regjistrimi 444, të lëshuar nga “ZAS Trade-Center” Prishtinë, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Nivelin e gjuhës angleze në nivelin C1, si dhe Certifikatën me numër regjistrimi 193, të lëshuar nga “ZAS Trade-Center” në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Nivelin e gjuhës angleze në C2. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës kandidati në fjalë ka bashkëngjitur: Letër rekomandimin e lëshuar me datë 08.11.2024, nga “Besimi Commerce” Sh.P.K, me të cilën dëshmohet se i njëjti nga data 01.10.2019 deri më 31.03.2020, ka qenë i angazhuar në pozitën e Menaxherit, përvojë kjo e dëshmuar edhe me *gjashtë (6) muaj* kontribute pensionale sipas pasqyrës së llogarisë së trustit; Letër rekomandimin e lëshuar nga RTV Dukagjini, me të cilën dëshmohet se kandidati në fjalë nga data 01.07.2023 deri më 31.09.2023, ka qenë i angazhuar si Gazetar Praktikant, ndërsa, nga data 01.10.2023 deri më 29.02.2024, ka qenë i angazhuar si Gazetar, përvojë kjo e dëshmuar edhe me *pesë (5) muaj* kontribute pensionale sipas pasqyrës së llogarisë së trustit pensional, si dhe

Kontratën e punës praktike me numër protokolli 6013, të datës 11.11.2024, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilën vërtetohet se kandidati ka qenë i angazhuar në pozitën e Praktikantit, nga data 15.10.2024 deri më datë 15.04.2025 (6 muaj). Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidati A.Z, me gjithsejtë 93.4, pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër 26, të lëshuar me datë 26.04.2005, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 10.09.2004, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik-Dega Administratë Publike, duke marrë titullin Bachelor i Administratës Publike, si dhe sa i përket plotësimit të kriterit specifik shtesë, ka bashkëngjitur Certifikatën me numër 733D59CF8C-733D59CFEF-733D59A7B1, të datës 19.11.2024, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin C1 të gjuhës angleze. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, kandidati në fjalë ka bashkëngjitur, Vërtetimin me Nr.093, të datës 28.10.2024, të lëshuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me të cilin vërtetohet se ka qenë në marrëdhënie pune në shërbim civil, prej datës 01.04.2015 deri më datën 01.04.2022,, në pozitën e Menaxherit të Burimeve Njerëzore, në kuadër të Kabinetit të Kryetarit. *(Kandidati posedon edhe përvojë tjetër, por Kolegji për shkak të numrit të madh të aplikacioneve ka administruar vetëm përvojën minimale me të cilën është plotësuar kriteri formal sipas konkursit të lartshënuar).* Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja M.S-S, me gjithsejtë 90.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr:123-12/2017, të datës 04.01.2018, të lëshuar nga Kolegji ESLG, me të cilën vërtetohet se më datë 21.12.2017, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Bachelor në Juridik, si dhe lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës ka bashkëngjitur, Akt emërimit me numër AE.Nr.44/2021, të datës 23.06.2021, me të cilën vërtetohet se kandidatja ka qenë e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Legjislacion në Departamentin e Sekretariatit Koordinues; si dhe Vendimin Nr.prot.03/2024, të datës 10.01.2024, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, me të cilin vërtetohet se lirohet nga pozita Zyrtare për Legjislacion, pasi që e njëjta ka paraqitur njoftimin me shkrim për dorëheqje në Zyrën e Kryeministrit; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër reference Nr.Ref.MPJD/KPNY 03/2024, të lidhur me datë 03.01.2024 në mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe ankueses, për pozitën e punës Asistente Ekzekutive, me kohëzgjatje të punësimit 1 vit (me mundësi vazhdimi) me një periudhë provuese prej 3 muaj, si dhe Kontratën e marrëdhënies së punës me numër reference Nr.Ref.MPJD/KPNY 03/2025, të lidhur me datë 28.02.2025 në mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe ankueses, për pozitën e punës Asistente Ekzekutive, me kohëzgjatje të punësimit për kohë të pacaktuar. Mirëpo, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja në fjalë lidhur me plotësimin e kriterit specifik shtesë, nuk ka bashkëngjitur dokumentet që dëshmojnë njohjen e gjuhëve të huaja të kërkuara sipas shpalljes së konkursit, përkatësisht e njëjta as në aplikacionin e saj nuk ka deklaruar ndonjë njohuri nga gjuhët dhe nivelit e të lexuarit, të folurit, të shkruarit dhe të kuptuarit e saj. Andaj, mbi bazë të provave të bashkëngjitura dhe konstatimit të sapo theksuar rezulton se kandidatja në fjalë, nuk ka plotësuar kriteret

e konkursit përkatës, përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi se plotëson kriterin specifik shtesë, për njohjen e një prej gjashtë gjuhëve të huaja sikurse është përcaktuar me shpalljen e konkursit.

-Kandidati B.K, me gjithsejtë 87.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.7492, të lëshuar me datë 27.08.2021, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimeve themelore më datë 27.07.2021, në Fakultetin Filozofik–Departamenti i Shkencave Politike, duke marrë titullin Bachelor i Shkencave Politike. Lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës si dhe atë plotësimin të kriterit specifik shtesë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati në fjalë nuk ka ofruar dëshmi se plotëson të njëjtat kriteret, për arsye se nuk ka bashkëngjitur dokumentet që dëshmojnë njohjen e gjuhëve të huaja të kërkuara sipas shpalljes së konkursit, ndërsa, referuar të dhënave nga Pasqyra e llogarisë së trustit, rezulton se kandidati në fjalë lidhur me përvojën e punës tek NGO “United Youth Task Force”, ka të mbuluara vetëm *nëntë (9) muaj* kontribute pensionale, dhe se përveç kësaj e njëjta përvojë pune është deklaruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, ngase kontratat e punës pranë këtij punëdhënësi i ka bashkëngjitur vetëm në gjuhën angleze. Rrjedhimisht, mbi bazë të provave të bashkëngjitura dhe konstatimit rezulton se kandidati në fjalë, nuk ka plotësuar kriteret e konkursit përkatës, përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi se plotëson kriterin e përvojës së punës dhe kriterin specifik shtesë për njohjen të një prej gjashtë gjuhëve të huaja sikurse është përcaktuar me shpalljen e konkursit.

-Kandidati B.B, me gjithsejtë 87.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.D-678/19, të datës 20.08.2019, të lëshuar nga Kolegji ISPE, me të cilën vërtetohet se ka përfunduar studimet themelore më datë 02.08.2019, në Fakultetin Ekonomik, duke marrë titullin Bachelor i Arteve në Ekonomi me Specializim Marketing, si dhe sa i përket plotësimin të kriterit specifik shtesë, ka bashkëngjitur Certifikatën me numër Nr.025-006, të lëshuar nga “Britannica ELT School”, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin C1 të gjuhës angleze. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, kandidati në fjalë ka bashkëngjitur Letër rekomandimin e lëshuar me datë 08.08.2023, nga LLC “De Bona Auto”, në të cilën theksohet se kandidati në fjalë, nga data 01.07.2020 deri më 10.08.2022, ka qenë i angazhuar pranë këtij punëdhënësi si Menaxher i Përgjithshëm, përvojë pune kjo nga sektori privat e mbështetur edhe me Pasqyrën e llogarisë së trustit pensional, me gjithsejtë *pesëmbëdhjetë (15) muaj* kontribute pensionale. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

- Kandidati N.I, me gjithsejtë 86.8 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me Nr.5516, të lëshuar me datë 15.09.2015 nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti me datë 27.07.2015, ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, Departamenti Menaxhment dhe Informatikës, duke fituar kështu titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë, si dhe sa i përket plotësimin të kriterëve specifike shtesë, ka bashkëngjitur Certifikatën e lëshuar nga “Harry S Truman College-Adult Education”, me anë të së cilës dëshmohet se i njëjti ka kompletuar përfundimin e gjuhës angleze të avancuar 7, ekuivalent me nivelin C1. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së

punës i njëjti ka bashkangjitur Vërtetimin/rekomandimin e punës të datës 27.02.2025, të lëshuar nga “Target-Kurs” Sh.P.K, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti nga data 01.11.2016 deri më 27.02.2024, ka qenë i angazhuar si ligjërues i lëndëve: Menaxhment financiar, kontabilitet financiar, menaxhim i investimeve, menaxhim i operacioneve, menaxhim i projekteve, statistikë dhe teknologjia informatike dhe planifikimin i projekteve, përfshirë edhe programin e softuerik “MS Project 2010”, në këtë shkollë të trajnimeve, dhe duke qenë se kjo përvojë pune hynë në kuadër të sektorit privat, kandidati në fjalë ka bashkëngjitur edhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, në të cilin dokument zyrtar figurojnë *mbi shtatë (7) vite apo tetëdhjetë e katër (84) muaj kontribute pensionale të paguara nga ky punëdhënës*. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidati M.R, me gjithsejtë 85 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr.6473, të datës 29.03.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se me datë 20.12.2018, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Shkencave Politike, duke marrë titullin Bachelor i Shkencave Politike; dhe Diplomën me numër Nr.7695, të datës 27.10.2021, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se me datë 08.09.2021, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Jurist i Diplomuar. Lidhur me plotësimin e kriterit specifik shtesë, kandidati ka bashkangjitur Certifikatën e datës 15.09.2025, të lëshuar nga Academic Education Center, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin e gjuhës angleze në C1. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, kandidati ka bashkangjitur, Vërtetimin me shifër Vr.Nr.610/2023 të datës 21.06.2023, të lëshuar nga U.D. Drejtori Ekzekutiv i Odës së Avokatëve, me të cilën vërtetohet se i njëjti ka përfunduar praktikën profesionale prej *një (1) viti*, duke qenë i angazhuar si Praktikant në zyrën e Avokatit Naim Rudari, nga data 22.06.2022 deri më datën 21.06.2023. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidati A.S, me gjithsejtë 84.8 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr. 259/18, të datës 30.10.2018, të lëshuar nga Kolegji Biznesi, me të cilën vërtetohet se i njëjti ka përfunduar studimet themelore më datë 10.07.2018, në Programin Menaxhment dhe Ekonomiks, duke marrë titullin Bachelor i Arteve në Menaxhment dhe Ekonomiks me Specializim në Menaxhment Biznesi, si dhe sa i përket plotësimit të kriterit specifik shtesë, ka bashkangjitur Certifikatën e datës 12.09.2025, të lëshuar nga Track Test, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin C1 të gjuhës angleze. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, kandidati në fjalë ka bashkangjitur: Kontratën për Shërbime të lidhur mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kandidatit, me datë 11.02.2019, për një periudhë kohore prej *gjashtë (6) muajsh*, nga data 11.02.2019 deri më datën 11.08.2019, për kryerjen e detyrave të punës pranë Departamentit për Çështje Konsullore/Divizioni për Shërbime Konsullore; Kontratën për Shërbime të lidhur mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kandidatit, me datë 19.08.2019, për një periudhë kohore prej *gjashtë (6) muajsh*, nga data 19.08.2019 deri më 19.08.2020, për kryerjen e detyrave të punës pranë Departamentit për Çështje Konsullore/Divizioni për Shërbime Konsullore. (*Kandidati posedon edhe përvojë tjetër, por Kolegji për shkak të numrit të madh të aplikacioneve ka administruar vetëm përvojën*

*minimale me të cilën është plotësuar kriteri formal sipas konkursit të lartshënuar*). Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja D.B, me gjithsejtë 84.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.8470, të datës 20.07.2023, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se e njëjta më datë 05.07.2023, ka përfunduar studimet themelore, në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Juriste e Diplomuar, si dhe lidhur me plotësimin e kriterit specifik shtesë, kandidatja në fjalë ka bashkëngjitur Certifikatën me numër 1233/024, të lëshuar nga “Britannica ELT School”, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin C1 të avancuar në gjuhës angleze. Ndërsa, përkitazi me përvojën e punës ka bashkëngjitur Certifikatën e datës 23.10.2024, e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me të cilën vërtetohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore pranë kësaj gjykate, në kohëzgjatje prej *një (1) viti*, nga data 24.10.2023 deri më datën 23.10.2024, dhe se mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidatja në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja A.Z-S, me gjithsejtë 84 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkëngjitur Diplomën e datës 22.07.2022, nga Laurea Ammattikorkeakoulu University of Applied Sciences, dhe marrë për bazë se diploma është fituar jashtë vendit, e njëjta ka bashkëngjitur edhe Përgjigjen me numër protokollit 11/3-3440 të datës 15.09.2025, të Divizionit për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik (NARIC) të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përmes së cilës rezulton se kandidatja në fjalë, ka paraqitur kërkesë për njohje/barasvlerë të diplomës të nivelit “BSc.Administrim Biznesi”, të fituar në “Universitetin e Shkencave të Aplikuara” në Finland, dhe e cila është në procedurë të njohjes/barasvlerës. Lidhur me plotësimin e kriterëve specifike shtesë, kandidatja ka bashkëngjitur Certifikatën me numër 1012339 të “SIDI Education” Sh.P.K, English Language viti akademik 2024/25, për kryerjen me sukses të nivelit C1. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit prej një (1) viti përvojë pune, kandidatja ka bashkëngjitur Vërtetimin e punës, të përkthyer me datë 15.09.2025, nga Përkthyesi-Interpreti Gjyqësorë Shqip-Finlandisht E.B, në të cilën theksohet se kandidatja nga data 10.01.2022 deri më 31.12.2022, ka punuar si praktikante dhe asistente financiare pranë Biisony Group Oy, përkatësisht nga data 10.01.2022-10.06.2022 në pozitën Praktikante Financiare, ndërsa, nga data 11.06.2022-31.12.2022 në pozitën Asistente Financiare, mirëpo duke marrë për bazë se e njëjta ka diplomuar me datë 22.07.2022, ani pse faktikisht kjo diplomë ende nuk është konstatuar se është njohur nga institucionet kompetente, Kolegji i Këshillit, në kontest të përvojës profesionale sikurse në këtë rast, thekson faktin se përvojë pune profesionale, konsiderohet vetëm përvoja e punës pas diplomimit e studimeve themelore, përcaktim ky tashmë i konsoliduar më praktikën vendimmarrës të Këshillit dhe praktiken vendimmarrëse të gjykatës (Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.614/2025), dhe për rrjedhojë, përvoja e punës para diplomimit në cilësinë e Praktikantes Financiare, nuk njihet si përvojë pune profesionale. Kandidatja në fjalë gjithashtu ka bashkëngjitur edhe Kontratën e punës të lidhur me datë 01.01.2025, me “Dielli Corporation” Sh.P.K dhe Referencën e datës 31.08.2025, përmes së cilave theksohet, se e njëjta nga data 01.01.2025 është e punësuar në pozitën Zyrtare Financiare, dhe se duke marrë për bazë se kjo përvojë pune është jashtë

institucioneve publike, Kolegji i Këshillit, i' u referua Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, e cila ka theksuar se: *dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmojnë me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale*, nga konstatohet se përvoja e punës në institucionet private, duhet të mbështetet me dokumentet përkatëse nga këto institucione, mirëpo, në rastin përkatës kandidatja në fjalë nuk ka bashkëngjitur dëshmitë konkrete, mbi të cilën kjo përvojë pune do të konsiderohej si përvojë pune profesionale pas diplomimit. Si rrjedhojë e kësaj, përkatësisht provave të bashkëngjitura Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja në fjalë nuk ka ofruar dëshmi se plotëson kriterin e përvojës së punës të përcaktuar me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja B.M, me gjithsejtë 84.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.239, të datës 02.09.2024, të lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", me të cilën vërtetohet se me datë 08.07.2024, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Juriste e Diplomuar, si dhe lidhur me plotësimin e kriterëve specifike, kandidatja ka bashkëngjitur Certifikatën e lëshuar me datë 24.06.2025 nga "London School", me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer me sukses Nivelin C1. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës ka bashkëngjitur: Kontratën për punë dhe detyra specifike, të datës 06.02.2025, të Peer Educators Network (PEN), në të cilën theksohet kandidatja për punët dhe detyrat specifike do të angazhohet nga data 06.02.2025 deri më 30.11.2025, mirëpo, përveç se përmes saj nuk përcaktohet pozita e ushtruar, apo se nuk përmbushet dëshmia ashtu siç është kërkuar me pikën 5, nën pikën 5.3 të shpalljes së konkursit, dhe se e njëjta gjithashtu duke u bazuar në nenin 61 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *1. Kontrata administrative lidhet në formë të shkruar, përveç rasteve kur me ligj parashihet një formë tjetër e posaçme. 2. Kontrata nënshkruhet nga palët apo përfaqësuesit e tyre.*; si e tillë është e pavlefshme në kuptim të paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të nenit 65 të këtij Ligji, ku përcaktohet se: *1. Një kontratë administrative nuk është e vlefshme për një nga këto shkaqe: 1.2. nuk është respektuar forma e kërkuar me ligj, në përputhje me dispozitat e nenit 61 të këtij Ligji;* ngase nga analizimi dhe shqyrtimi i kësaj kontrate, rezulton se nuk është nënshkruar nga dy palët, përkatësisht nga punëdhënësi. Ndërsa, sa i përket Vërtetimit të datës 14.09.2024 të lëshuar nga CECD Friends, me të cilin theksohet se e njëjta ka qenë e angazhuar pranë kësaj organizate nga data 01.08.2024 deri më datën 10.09.2024, si praktikante në aktivitetet me zyrtarët ligjor, Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i dosjes së kandidatës, nuk ka gjetur ndonjë provë tjetër ndërlidhur me këtë përvojë pune në cilësinë e praktikantes në sektorin privat, gjegjësisht nga pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale (Trusti), të së njëjtës nuk i figurojnë fare kontribute nga ky punëdhënësi, mirëpo sipas dispozitave ligjore në fuqi janë paraparë edhe procedurat e angazhimit të praktikanteve, ku sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212, respektivisht me nenin 16, është përcaktuar se: *Punëdhënësi mund të lidhë Kontratë Pune me praktikantin. 2. I punësuarit në cilësinë e praktikantit i cili ka lidhur kontratë pune me punëdhënësin, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit e tjerë. ..4. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj. 7 5. Punëdhënësi në marrëveshje me personin e interesuar mund të angazhojë praktikant pa ndonjë kompensim të pagës dhe*

të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, përveç që duhet të ofrojë mbrojtje dhe siguri në vendin e punës sipas ligjit. **Punëdhënësi i cili e angazhon praktikantin pa kompensim page, është i obliguar ta evidentojë praktikantin në listën e evidencave pa kompensim page...**”. Rrjedhimisht, bazuar në sqarimet e dhënë nga Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me këtë përvojë pune, rezulton se praktikantët të cilët angazhohen për kohë të caktuar dhe të cilët nuk paguhen nga punëdhënësi, duhet të dëshmojnë me marrëveshje se praktika është pa kompensim, nga rrjedhë se vërtetimi përkatës nuk është provë e vlefshme apo e mjaftueshme që vërteton përvojën e punës së kësaj kandidateje pranë këtij punëdhënësi, ngase e njëjta kandidate nuk ka dorëzuar dëshmi tjetër, si marrëveshje me personat e autorizuar të punëdhënësit apo edhe shënime nge evidenca, se e njëjta ka qenë e angazhuar pa pagesë/vullnetarisht pranë punëdhënësit përkatës. Gjithashtu, Kolegji ka gjetur se kandidatja ka bashkëngjitur edhe Kontratën për punë praktike me numër protokolli 6009, të datës 11.11.2024, me të cilën dëshmohet se kandidatja nga data 15.10.2024 deri më 15.04.2025 (*gjashtë muaj*), ka vijuar praktikën pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kontratën për punë praktike me numër protokolli 2056 të datës 03.06.2025, me të cilën dëshmohet se kandidatja ka lidhur kontratë për kryerjen e praktikës me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për periudhën kohore nga data 15.04.2025 deri më 15.10.2025 (*pesë muaj deri në datën e aplikimit*). Si rrjedhojë e kësaj, përkatësisht provave të bashkëngjitura Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja në fjalë nuk ka ofruar dëshmi se plotëson kriterin e përvojës së punës të përcaktuar me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja B.V, me gjithsejtë 83 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.5250, të datës 11.01.2018, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se me datë 18.11.2017, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Juriste e Diplomuar. Ndërsa përkitazi me përvojën e punës kandidatja posedon, Certifikatën me numër A.GJ.nr.90/19, të datës 12.02.2019, të lëshuar nga Gjykata e Apelit, me të cilën vërtetohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një (1) viti, pranë kësaj Gjykate dhe atë nga data 13.02.2018 deri më datën 12.02.2019, po ashtu posedon edhe Certifikatën e datës 28.05.2025, të lëshuar nga Anglia Academy Kosovë, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kursin e gjuhës angleze në nivelin C1 të avancuar. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidatja në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidati D.P, me gjithsejtë 78.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.6596, të datës 22.07.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se ka përfunduar studimet themelore më datë 05.07.2019, në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Shkencave Politike, duke marrë kështu titullin Bachelor i Shkencave Politike, si dhe lidhur me plotësimin e kërkesave specifike shtesë ka bashkëngjitur Certifikatën me numër Nr.124056, të datës 13.01.2025, të lëshuar nga Future Education, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar nivelin C1 të gjuhës angleze. Ndërsa, sa i përket përvojës së punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkëngjitur Marrëveshjen e Shërbimit 016 SIDA.NVK 2020, të lidhur me datë 15.10.2020, në mes OJQ “Nevo Koncepti” dhe kandidatit, për pozitën Fasilitator, për periudhën kohore të shërbimit nga data 15.10.2020 deri më 15.11.2020; Kontratën e punës të datës 01.04.2021, të lidhur mes kandidatit dhe Teach for Kosova, për kohë të caktuar nga data 01.04.2021 deri më 31.08.2021, për pozitën Konsulent; Kontratën e punës të datës 01.07.2021, të lidhur

mes kandidatit dhe Teach for Kosova, për kohë të caktuar nga data 01.04.2021 deri më 31.08.2021, për pozitën Koordinator i terrenit; Marrëveshjen e Shërbimit 058 VoRAE/NVK 2023, të lidhur me datë 15.10.2020, në mes OJQ “Nevo Koncepti” dhe kandidatit, për pozitën Ligjërues dhe për periudhën kohore të shërbimit nga data 01.11.2023 deri më 15.03.2024. Lidhur me këtë përvojë pune nga sektori privat, kandidati sipas Pasqyrës së llogarisë së trustit pensional, rezulton se ka gjithsejtë *pesëmbëdhjetë (15) muaj* kontribute pensionale, përkatësisht *dhjetë (10) muaj* tek punëdhënësi Teach for Kosova dhe *pesë (5) muaj* tek OJQ “Nevo Koncepti”. Gjithashtu, kandidati ka bashkëngjitur Kontratën e punës (Bashkëpunëtor i Jashtëm) me numër protokolli 308 05-222 të datës 26.12.2024, të lidhur mes Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti Juridik, dhe kandidatit në fjalë, me kohëzgjatje prej datës 01.10.2024 deri 15.01.2025 dhe 16.02.2025 deri 31.05.2025. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

-Kandidatja E.K, me gjithsejtë 74.2, pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, ka bashkëngjitur Diplomën me numër Nr.8554, të datës 13.09.2023, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se më datë 05.07.2023, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke marrë titullin Bachelor në Juridik. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterëve specifike shtesë, e njëjta ka bashkëngjitur Certifikatën me Nr.1250062015 të datës 30.06.2015, të lëshuar nga “New Age School”, për përfundimin nivelit B1+ të gjuhës angleze; Certifikatën me Nr.1259012013 të datës 29.01.2013, të lëshuar nga “New Age School”, për përfundimin nivelit A1+ të gjuhës angleze; Diplomën e lëshuar nga “The Cambridge School”, me ref.nr.28132/15, për përfundimin e kursit të gjuhës italiane A1-A2; Certifikatën me Nr.0524122014 të datës 06.12.2014, të lëshuar nga “Neë Age School”, për përfundimin nivelit B1 të gjuhës angleze; Certifikatën e lëshuar nga “Qendra e Gjuhës dhe Kulturës Italiane”, për përfundimin e kursit të gjuhës italiane në nivelin A1; Shkresën, përmes së cilës kandidatja ka vet theksuar, se gjatë shkollimit në institucionin arsimor “Mileniumi i Tretë”, ka ndjekur dhe përfunduar me sukses të gjitha nivelet e gjuhës angleze të ndara sipas kurseve të shkollës, deri në nivelin C1. Nisur, nga këto dokumente të sapo theksuara, e duke marrë për bazë kërkesat specifike shtesë të vendosura në shpalljen e konkursit dhe dokumentet që duhet dorëzuara, ku përmes së cilave rezulton se të gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar me dëshmitë e kërkuara për plotësimin e këtyre kërkesave dhe kriterëve specifike shtesë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja në fjalë nuk ka plotësuar kriterin e njohjes së njërës prej gjashtë gjuhëve të huaja në nivelin C1 apo C2, ngase nuk ka bashkëngjitur dokument apo certifikatë të lëshuar nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose nga studimet universitare të kryera në njërën nga gjuhët angleze, gjermane, frënge, italiane, greke dhe spanjolle për njërën nga nivelet përkatëse. Si rrjedhojë, e kësaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se kandidatja në fjalë nuk ka plotësuar kërkesat specifike shtesë, ndaj me këtë rast edhe shqyrtimi i dokumenteve lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës është bërë panevojshëm apo i kotë.

-Kandidati A.P, me gjithsejtë 73.6 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e tij, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor dhe plotësimin të kriterit specifik shtesë ka bashkëngjitur, Diplomën e lëshuar në muajin Qershor të vitit 2011, nga “The Bernard M. Baruch College”, dhe duke qenë se kjo diplomë është fituar jashtë Republikës së Kosovës, e njëjta është njohur me Vendimin Nr.614-782 të datës 24.06.2024, nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Këshilli Shtetëror për Njohje, përmes të cilit dëshmohet se i njëjti ka fituar gradën Bachelor në Administrim

Biznesi. Ndërsa, sa i përket përvojës së punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkëngjitur Vërtetimin e marrëdhënies së punës me numër protokoll 2683 të datës 24.07.2025, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti nga data 08.04.2022 deri më 17.01.2024, ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij institucioni. Andaj, mbi bazë të këtyre provave materiale rezulton se kandidati në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kriteret specifike shtesë të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës.

- Kandidatja A.D, me gjithsejtë 71 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, në aplikacionin e saj, si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkëngjitur, Diplomën me Nr.7550 të lëshuar me datë 21.07.2021, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se e njëjta me datë 05.07.2021, ka mbaruar studimet në Fakultetin Juridik, duke fituar kështu titullin Juriste e Diplomuar. Mirëpo, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja në fjalë lidhur me plotësimin e kriterit specifik shtesë, nuk ka bashkëngjitur dokumentet që dëshmon njohjen e së njëjtes prej gjashtë gjuhëve të huaja në nivelin C1 apo C2, ngase nuk ka bashkëngjitur dokument apo certifikatë të lëshuar nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose nga studimet universitare të kryera në njërin nga gjuhët angleze, gjermane, frënge, italiane, greke dhe spanjolle për njërin nga nivelet përkatëse. Si rrjedhojë, e kësaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se kandidatja në fjalë nuk ka plotësuar kërkesat specifike shtesë, ndaj me këtë rast edhe shqyrtimi i dokumenteve lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës është bërë panevojshëm apo i kotë.

Rrjedhimisht, bazuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e provave veç e veç, dhe me këtë rast konstatimeve dhe arsyetimeve si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si njësi përgjegjëse në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidateve që plotësojnë kriteret e konkursit, rrjedhimisht me rastin e përfshirjes në listën e ngushtë të kandidateve M.S-S, kandidatit B.K, kandidate B.M, kandidate A.Z-S, kandidate E.K dhe kandidate A.D, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike si dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, ka përfshirë në listë të ngushtë kandidatë, të cilët nuk i kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kërkesat specifike shtesë, të Konkursit me Nr. reference RN00018442, dhe se të njëjtit kandidatë më tej janë shpallur kandidatë fitues, ndërsa, prej tyre katër (4) kandidatë janë rekomanduar për emërim, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;* ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.7 të këtij Ligji dhe nenin 7, paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil.

Nisur, nga konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, po ashtu vë në dukje faktin se Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Komisioni i Pranimin, janë organe kompetente dhe përgjegjëse për zhvillimin e një procedure të rekrutimit dhe se çdo veprim në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e pranimin në shërbim civil, konsiderohet shkelje disiplinore dhe i nënshtrohet procedurës disiplinore të rregulluar me Kapitullin IV të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet e më sipërme të këtij vendimi, përkatësisht në konstatimin se pretendimet e ankuesit nuk janë vërtetuara si të bazuara, e për rrjedhojë si të tilla rezultojnë si të paqëndrueshme, dhe marrë parasysh se kandidatja M.S-S, kandidati B.K, kandidatja B.M, kandidatja A.Z-S, kandidatja E.K dhe kandidatja A.D, nuk kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale dhe kërkesat specifike shtesë, të Konkursit me Nr. reference RN00018442, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 132, paragrafi 4, dhe nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të aprovohet pjesërisht si bazuar ankesa, ashtu që ndryshohen Lista e verifikimit paraprak lidhur me konkursin me numër të referencës RN00018442; Njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, lidhur me pragun e kalueshmërisë së kandidatëve nga testi me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe Njoftimi me Nr. prot. 3972 i datës 31.10.2025, për kandidatët fitues, në atë mënyrë që: kandidatët M.S-S, B.K, B.M dhe A.Z-S, largohen nga Lista e verifikimit paraprak, Njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, Renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe Njoftimi me Nr. protokoll 3972 i datës 31.10.2025, për kandidatët fitues, ndërsa, kandidatet E.K dhe A.D, largohen nga Lista e verifikimit paraprak, njoftimi Nr. Ref.1118/2025 i datës 03.10.2025, dhe Renditja përfundimtare e kandidatëve, me obligimin ligjor që Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative, ashtu që duke u bazuar në pikëpamjet e arsytimit të këtij vendimi, të bëjë përzgjedhjen e kandidatit të dymbëdhjetë (12) fitues për pozitën e punës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, duke u bazuar në Renditjen përfundimtare të kandidatëve, të ndryshuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

**Lënda me numër A.nr.1909/2025**

**Atdhe GASHI**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.G;
- Udhëheqësit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.